

PROCESVERBAL 25/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 8 (tetë) të rregullt për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 25.07.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6343 të datës 28.01.2022;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;**
4. **Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6343 të datës 28.01.2022;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që në kuadër të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në bazë të udhëzimit administrativ është e obligueshme që të jetë edhe kryetari i këshillit të prindërve. Në bazë të informacioneve që kemi dhe kërkesës që e kemi nga DKA, përfaqësuesi i këshillit të prindërve në kuadër të Komunës së Suharekës është ndërru dhe në vend të Adem Dërgutit është zgjedh Herolinda Berisha. Ne e kemi obligim që vendimin për themelimin e KKSB-së ta bëjmë plotësim-ndryshim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-7541 i datës 29.01.2021;

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për një vendim të vitit 2021, ku atëherë Kuvendi i Komunës e ka miratu ofertën për dhënie në shfrytëzim në Biraq, firmës "Cima" për ndërtimin e stadiumit të qytetit mirëpo ai nga atëherë e deri më sot nuk ka pranuar ta nënshkruaj kontratën për arsye se në kuadër të nenit 3 janë disa obligime që parashihen, që firma e cila shpallet fituese ka për obligim që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit që ta sjell garancionin bankar të 10% të vlerës së investimeve që i ka prezentu vet në ofertë, mirëpo një kohë nuk ka pranuar me sjell dhe ne kemi ardhë në përfundim që ai vendim të shfuqizohet dhe prona të lirohet.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4.Të ndryshme;

Kryesuesi - si pikë unë e kisha shtu: Gjendja e nxënësve të komunitetit romë-ashkali-egjiptian në shkolla.Kemi disa probleme te paisja e librave me vendimin e Ministrisë së Arsimit lidhur me aplikimin online për mjetet.Te unë janë paraqit shumë raste që kanë pas problem me u qas në sistem dhe me apliku. Duke e pas parasysh këtë problem dhe një problem që kemi pas më herët për mungesën e nxënësve nëpër shkolla,unë po planifikoj që gjatë muajit tetor të organizohet një vizitë me anëtarët e komisionit të Komunitetit për Komunitete dhe ta bëjmë një vizitë në shkollën fillore “Drita” në Gelancë ku do të diskutojmë lidhur me gjendjen e nxënësve dhe çështjen e mungesave të komunitetit romë-ashkali-egjiptian.Për takimin do të ju njoftojmë me email.Nëse jeni për këtë pikë dhe a keni diçka me shtu?

Aziz Bytyqi - për shkak të angazhimeve që kam nëse është e mundur që ky takim të mbahet javën tjetër,të hënë nga ora 09:00.

Kryesuesi - në këtë takim mund të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it dhe të OSBE-së.

Takimi përfundoi:09:15